

Takim dialogues mbi Rregulloren e BE për Gigabit Infrastructure Act (GIA)

Më datë 3 Nëntor 2025, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare organizuan në Hotel Plaza Tiranë, takimin dialogues mbi politikat dhe reformat në planin e rritjes për infrastrukturat digjitale dhe procesin e integritimit në BE.

Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i ecurisë së Shqipërisë në lidhje me zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, rrjeteve me shpejtësi të lartë, objektivave për infrastrukturat gigabit, si dhe diskutime mbi nevojën e përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator sipas Rregullores së BE për GIA (Gigabit Infrastructure Act). Gjithashtu ky takim synon të bëjë bashkë përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve publike, operatorëve të komunikimeve elektronike dhe bashkive, për të diskutuar mbi agjendën e reformave për infrastrukturat digjitale dhe rolin e aktorëve në suksesin e saj.

Fjala hapëse e takimit u mbajt nga znj. Enkelelda Muçaj Zëvendësministre e MIE, e cila theksoi ecurinë dhe përparimin e Shqipërisë në zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, nevojën për ndërtimin e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë sipas ligjit të ri të komunikimeve elektronike, objektivat për infrastrukturat gigabit, si dhe nevojën e përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator sipas Rregullores së BE për GIA (Gigabit Infrastructure Act), transpozimin e këtij akti në një ligj të ri brenda muajit qershor 2026, afat i vendosur në Agjendën e Reformave.

Më pas fjalën e mori Kryetari i AKEP z. Gentian Sala, i cili pasi bëri një rezyme mbi shifrat e raportuara në lidhje me zhvillimin e rrjeteve broadband dhe sesi ka ndryshuar numri i abonentëve, u kërkoi të pranishmëve të vijonin bashkëpunimin e frytshëm të mëtejshëm.

Nga MIE, u prezantua roadmapi për harmonizimin e GIA, hapat që do të kalojë procesi për transpozimin e GIA, organizimi i takimeve të tjera me aktorët e përfshirë në proces, mbledhja dhe konsultimi me komentet e tyre për projektligjin e ri të GIA, deri në miratimin e tij.

